

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

## PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2014

### SESIONI I

### VARIANTI A

E mërkurë, 18 qershor 2014

Ora 10.00

**Lënda: Qytetari**

**Udhëzime për nxënësin**

Testi në total ka **20 pyetje**.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

**Për përdorim nga komisioni i vlerësimit**

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	
Pikët							

Totali i pikëve

**KOMISIONI I VLERËSIMIT**

1.....Anëtar

2.....Anëtar

- 1. Shpjegoni:** **3 pikë**
- a) funksionin parandalues të ligjit. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- b) përmbajtjen e ligjit civil. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- c) thelbin e konceptit “kode”. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 2. Neni 9/2 në Kushtetutën e RSH thotë se, partitë politike dhe organizata të tjera, programet dhe veprimtaritë e të cilave mbështeten në metoda totalitariste ... janë të ndaluara sipas ligjit. Kjo lidhet me parimin e:** **1 pikë**
- A) ndarjes së pushteteve  
B) kushtetuetshmërisë  
C) pluralizmit  
D) sovranitetit
- 3. Opozita kërkon të zhvillojë një manifestim paqësor në sheshin kryesor të qytetit. Për këtë ajo bën kërkesë sipas ligjit në organet përgjegjëse. Organet e rendit nuk japin leje për këtë manifestim, me argumentin se ai do të shkaktojë pakënaqësinë e shumicës. Çështja shkon në gjykatë. Tregoni që:** **3 pikë**
- a) çështja konkrete lidhet me \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- b) liria për tubim paqësor detyron shtetin të \_\_\_\_\_
- c) të garantosh të drejtën për tubime paqësore dhe të pjesmarrjes në to, do të thotë që shteti \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 4. Liria individuale e zgjedhjes në lidhjen e martesës realizohet më shumë në familjen:** **1 pikë**
- A) e hapur  
B) patriarkale  
C) e mbyllur  
D) e çdo tipi
- 5. Shpjegoni ndikimin që ka në plakjen e popullsisë:** **3 pikë**
- a) rritja e pakontrolluar e popullsisë në vendet e mëdha dhe të varfëra. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- b) politikat antilindje \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- c) pozita shoqërore e gruas \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 6. Përshkruani tri probleme që ka shkolla jonë sot lidhur me:** **3 pikë**
- a) tekstet shkollore \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- b) programet mësimore \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- c) mësuesit \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

7. Identifikoni nga një të drejtë të parashikuar në ligjet shqiptare për fëmijët lidhur me: **3 pikë**
- a) mbrojtjen nga shfrytëzimi \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- b) arsimimin \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- c) shprehjen e mendimit \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
8. Përcaktimi i termit ligjor fëmijë në ligjin shqiptar lidhet me moshën: **1 pikë**
- A) para se të fillojë përgjegjësia penale.  
B) para se të fillojë kundravajtja penale.  
C) e mbarimit të adoleshencës.  
D) kur fitohet e drejta e votës.
9. Përshkruani problemet e mëposhtme me të cilat përballlet adoleshenti. **3 pikë**
- a) braktisja nga të tjerët \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- b) afirmimin e statusit social të moshës \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- c) përzgjedhja e shokut/shoqes së ngushtë \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
10. Një nxënës i klasës së tetë në arsimin bazë punonte me dëshirë, me orë të kufizuara në biznesin e një të njohuri të prindërve të tij, për arsye ekonomike. Puna niste herët në mëngjes, por nuk e sforconte shumë. Pasoja më e rëndë për të lidhet me: **1 pikë**
- A) shkollën  
B) ekonominë  
C) shëndetin  
D) shoqërinë
11. Për jetën e njeriut ndikon prishja e ekuilibrave ekologjikë si: **1 pikë**
- A) efekti serë, rritja e varfërisë, por jo bota e mbipopulluar.  
B) bota e mbipopulluar, rritja e varfërisë, por jo efekti serë.  
C) efekti serë, bota e mbipopulluar, por jo rritja e varfërisë.  
D) efekti serë, rritja e varfërisë dhe bota e mbipopulluar.
12. Termi ushqim NUK përfshin: **1 pikë**
- A) pijet  
B) produktet e përpunuara  
C) produktet mjeksore  
D) ujin mineral
13. Ligji për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit: **1 pikë**
- A) ndalon reklamën dhe pirjen e duhanit në të gjitha mjediset publike të mbyllura.  
B) ndalon pirjen e duhanit në të gjitha mjediset publike të mbyllura dhe lejon reklamën.  
C) ndalon reklamën dhe lejon pirjen e duhanit në të gjitha mjediset publike të mbyllura.  
D) lejon edhe pirjen e duhanit në të gjitha mjediset publike të mbyllura, edhe reklamën e tij.

- 14.** Tregoni rrezikun që i vjen shëndetit nga: **3 pikë**
- a) stresi \_\_\_\_\_
- b) depresioni \_\_\_\_\_
- c) kequshqyerja \_\_\_\_\_
- 15.** Identifikoni tri vlera ushqimore, sipas domosdoshmërisë që kanë për shëndetin, përveç sheqernave. **3 pikë**
- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_
- 16.** Ndër faktorët kulturorë që ndikojnë në sjelljen e konsumatorit janë: **1 pikë**
- A) kultura, nënkultura, por jo klasa sociale
- B) kultura, klasa sociale, por jo nënkultura
- C) klasa sociale, nënkultura, por jo kultura
- D) kultura, klasa sociale dhe nënkultura
- 17.** Tregoni tri sinjale rrugore që i japin përparësi këmbësorit. **3 pikë**
- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_
- 18.** Disa fëmijë duan të kalojnë në anën tjetër të rrugës. Semafori ndizet për këmbësorin, por ata hezitojnë të kalojnë. Polici jep shenjën të kalojnë makinat e krahut tjetër. Si do t'i ndihmonit ju fëmijët? **1 pikë**
- A) Kaloni se semafori është për këmbësorë
- B) Kaloni rrugën bashkë me fëmijët
- C) I këshilloni fëmijët të presin sinjal nga polici
- D) Vraponi kur gjeni momentin pa rrezik
- 19.** Ligji për median: **1 pikë**
- A) e kufizon të drejtën e saj për të informuar publikun
- B) e ruan atë nga pushteti politik
- C) rrit mundësinë e abuzimit të saj
- D) rrit të drejtën e saj për të ndërhyrë në jetën private
- 20.** Shpesh herë në media, nga goja e personaliteteve të saj dhe të politikës, dëgjojmë të akuzohen individë, politikanë etj., për kryerjen e veprave penale, për të cilat edhe duhet të dënohen sipas ligjit. Shpjegoni në ç'mënyrë ligji për mediet e ruan atë nga abuzimet kur ligji: **3 pikë**
- a) shpall atë që medias nuk i lejohet të \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- b) shpall atë çfarë media duhet të respektojë \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- c) shpall se media duhet të respektojë të drejtat e njeriut \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_